

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Drafti i PS-së për pagat e magjistratëve, KLP: Rritja është minimale, diferenca me përlogaritjen tonë shu më e madhe
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/drafti-i-ps-se-per-pagat-e-magjistrateve-klp-rritja-eshte-minimale-dife-i586261
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:37:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6f532d1d9e4e91a2673c676db48e6f155d59b51fb16db7d6f257be54e06a9c01
TEKSTI	02fee6c1e5aa979b3032a18769df4b3e80db65144ff85e890eff35f4309995c2
PAMJA	6fcea221acd4eaf0158533e63f959ddc2f1e639fac7bdb9fe4a14382da473a0a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	79f3cc13a78973a67fa98ad67989e5154e519d82cc028a1bf76152151722ee58
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/79f3cc13a78973a67fa98ad67989e5154e519d82cc028a1bf76152151722ee58>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie [Drafti i PS-se per pagat e magjistrateve. KLP: Rritja eshte minimale, diferenca me perlllogaritjen tone shume e madhe](#)Kama tton gjyqtaret ne tryeze/ Çupi: Nje histori qe k fundit

Drafti i PS-së për pagat e magjistratëve, KLP: Rritja është minimale, diferenca me përlllogaritjen tonë shumë e madhe



15 Shtator 2026, 14:35Politika TEMA



Në Komisionin e Ligjeve po shqyrtohet drafti i PS-së për pagat e magjistratëve, me seanca dëgjimore me drejtuesit e institucioneve të drejtësisë. Kryetarja e KLP-së, Mirela Bogdani, kundërshtoi formulën e propozuar nga socialistët, duke e cilësuar rritjen minimale dhe shumë larg përlllogaritjes së bërë nga vetë Këshilli. Drafti i PS parashikon një rritje me rreth 8500 lekë për rrogën referuese të magjistratëve, ndërkohë që pretendimi i tyre, i miratuar edhe nga KLGJ e KLP, është 9-fish më i lartë, rreth 80 mijë lekë më e lartë.

“Këshilli ka vlerësuar se, në një ndërhyrje në sistemin e pagave të magjistratëve, duhet të shihet oportuniteti për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm, jo thjesht një ndërhyrje për të përmbushur formalisht detyrimin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese. Në vijim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ka kaluar edhe afati i 31 korrikut, Këshilli ka diskutuar në seanca se ku duhet të jetë paga referuese.

Pavarësisht kësaj, ne ndonëse nuk jemi njohur në detaje me projektligjin që është kaluar dje nga Komisioni i Ekonomisë, në referim të atij informacioni që kemi marrë për një rritje 0.02%, pra një rritje që është minimale krahasuar me atë që ka përlllogaritur vetë Këshilli, do të thoja se ka një diferencë shumë të madhe. Nuk reflekton standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese dhe standardin që vetë referimi i pagave ka bërë për sistemin e administratës shtetërore”, u shpreh Mirela Bogdani duke theksuar vendimi i Kushtetueses është i detyrueshëm për zbatim.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama fton gjyqtarët në tryezë/ Çupi: Një histori që ka shkaktuar tension në publik, u treguan mizorë me paratë e shqiptarëve](#)

14:25 Politika

Rama uron Kurtin për mandatin e ri: Të përshpejtojmë rrugëtimin drejt familjes europiane

14:20 Politika

"Pasqyrë Albania" / Koçi: Administratë më efikase dhe më pranë qytetarëve

13:45 Politika

Gogu: Secili pushtet në vendin e vet; Kuvendi humbi afatin, por zgjidhja për pagat bëhet me ligj

13:05 Politika / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.